



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 56/2012
Prishtinë, më 03.04.2012, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Fikrim Damka, Berat Buzhala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Teuta Sahatqija, Sala Berisha – Shala dhe Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi – ZPRK, Fatmir Morina - Ambasada e SHBA dhe Florije Mehmeti – KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.03.2012;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-098 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me gjashtë (6) vota Për dhe dy (2) vota Kundër.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.03.2012

Procesverbali i mbledhjes së datës 21.03.2012 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-098 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror

Kryetari – Tha se në këtë mbledhje kemi për rishqyrtim Projektligjin nr. 04/L-098 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror, për të cilën KFOR-i dhe partnerët tanë, kanë pasur kërkesë për rishqyrtimin e disa neneve dhe të amendamenteve. Shtoi se vërejtjet e tyre duhet të merren parasysh për shkak të kontributit që ata kanë dhënë deri më tani në ndërtimin e kapaciteteve dhe për shkak të ndjeshmërisë që kanë shërbimet e navigacionit ajror. Në vazhdim i paraqiti amendamentet e ndryshuara ose amendamentet e reja, si në vijim: 6, 7, 8, 10, 11, 12, 14, 15, 16, 17, 18, 20, 21, 22, 23, 25, 26, 29 dhe 34. Theksoi se amendamenti 27 shton një nen të ri dhe se amendamentet 13 dhe 32 janë të Komisionit për Buxhet. Kërkoj nga deputetët t'i përkrahin propozimet për plotësimin dhe për ndryshimin e amendamenteve të propozuara për Projektligjin për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror.

Myzejene Selmani - Kërkoj të diskutohen vetëm ato amendamente, në të cilat ka pasur plotësim dhe ndryshim, ose amendamentet e reja, sepse amendamentet e tjera janë miratuar në mbledhjen e kaluar të Komisionit.

Lutfi Zharku – Shfaq shqetësimin lidhur me atë se grupi i punës dhe Komisioni pasi i ka trajtuar të gjitha kërkesat ose propozimet e të gjitha palëve dhe pasi ka organizuar dëgjim publik për këtë Projektligj, përsëri kemi vërejtje shtesë. Kjo po ndodh edhe pasi janë kaluar të gjitha procedurat, madje edhe në komisionet e përhershme.

Ramiz Kelmendi – Nëse drejtori i Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror emërohet nga Kryeministri, kemi emërim politik dhe jo emërim në bazë të kriterëve profesionale. Kjo çështje është mirë t'i lihet Kuvendit, siç është vepruar edhe për disa agjenci të tjera.

Berat Buzhala - Ky nuk është emërim politik, sepse kjo çështje është e rregulluar më një konkurs të rregullt, ku janë përcaktuar kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror.

Komisioni pas debatit, më gjashtë (6) vota Për dhe një (1) votë Abstenim, nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 04/L-098 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror

4. Të ndryshme

a) Bordet e agjencive të pavarura

Kryetari – Kërkoi nga Njësia Mbështetëse e Komisionit t'ia përgatisë një listë, ku do të figurojnë të gjitha agjencitë dhe rregullatorët e pavarur, që i raportojnë Komisionit, që të shohim gjendjen e mandateve të bordeve. Pas kësaj t'i dërgohet një shkresë Qeverisë për njoftim. Kjo nuk do të thotë që përsëri, për secilin Bord, të kërkohet nga Qeveria të paraqesë kandidatët e mundshëm për emërim.

b) Mbledhja e radhës

Kryetari – I njoftoi deputetët se ka lëndë në pritje, si: Lista e rentave minerare, si dhe Raportet vjetore të ARH-së dhe AAC-së.

Komisioni vendosi që në mbledhjen e radhës të organizohet një seance dëgjimore për shqyrtimin e Listës së rentave minerare.

c) Kërkesa e deputetit Ramiz Kelmendi për ndryshimin e legjislacionit për bujqësinë

Ramiz Kelmendi – Theksoi se Komisioni duhet të gjejë mënyrën si duhet të bëhen ndryshimet ose plotësimet e mundshme të legjislacionit, që të jenë në favor të bujqësisë dhe të agrarit në përgjithësi, në mënyrë që ta luftojmë këtë informalitet që ekziston. Shtoi se ka kontaktuar me Komisionin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe ka mbështetjen e tyre në këtë drejtim.

Kryetari – Theksoi se duhet të gjejmë mënyrën, që në bashkëpunim me Komisionin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, të organizojmë një mbledhje ose një tryezë të përbashkët dhe t'i ftojmë ministrin e Bujqësisë dhe ministrin e Financave, që të shikojmë se çfarë mund të bëjmë në këtë drejtim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit